




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATË PRATKIMORË SHUMË: DATE PRELIMINARY SUBMITTED:			
Niveli Org. Org. Jedim. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Fjalëve Br. Fjalëve No. Pages
01	410	663	3



**ZKA**  
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

**MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI  
PËR  
PËR NISMA TË PËRBASHKËTA NË FUSHËN E SIGURISË, ZHVILLIMIT  
INSTITUCIONAL DHE FUQIZIMIT TË GRAVE NË SEKTORIN E SIGURISË**

**Kjo marrëveshje mirëkuptimi nënshkruhet ndërmjet:**

- I. FONDACIONI JAHJAGA** ( në tekstin e mëtejshëm JF), me adresë: rruga “Sylejman Vokshi” nr. 21, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, i përfaqësuar nga znj. Egzona Bexheti, Drejtoreshë Ekzekutive.
- II. ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT(ZKA)**, me adresë: rruga “Ahmet Krasniqi” nr.210, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga znj.Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme.

**Neni 1  
QËLLIMI**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje të Mirëkuptimit është të vendosë një kornizë bashkëpunimi ndërmjet palëve për zhvillimin dhe zbatimin e nismave të përbashkëta në fushën e sigurisë, zhvillimit institucional dhe fuqizimit të grave në sektorin e sigurisë.

**Neni 2  
FUSHAT E BASHKËPUNIMIT**

1. Bashkëpunimi ndërmjet palëve mund të përfshijë, por nuk kufizohet në:
  - 1.1. Programe mentorimi, trajnime, shkëmbim ekspertize dhe rrjetëzim profesional;
  - 1.2. Tryeza diskutimi, forume dhe punëtori teknike;
  - 1.3. Shkëmbim të praktikave të mira ndërmjet institucioneve të sigurisë dhe aktorëve të shoqërisë civile;
  - 1.4. Hulumtime, analiza dhe publikime që mbështesin zhvillimin e politikave në fushën e sigurisë.
2. Fushat dhe aktivitetet specifike të bashkëpunimit do të përcaktohen, bazuar në komunikim zyrtar dhe planeve konkrete operationale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 3**  
**PROJEKTE DHE NISMA TË NDËRLIDHURA**

1. Palët marrin parasysh se bashkëpunimi i tyre mund të përfshijë edhe aktivitete të zhvilluara në kuadër të projekteve dhe nismave të financuara nga donatorë ndërkombëtarë, përfshirë nisma si projekti i financuar nga Mbretëria e Holandës përmes Fondit MATRA dhe Fondit për të Drejtat e Njeriut, si dhe programe të tjera relevante në fushën e sigurisë dhe fuqizimit të grave.
2. Modalitetet konkrete të bashkëpunimit, përfshirë rolet dhe përgjegjësitë e palëve, do të përcaktohen përmes planeve zbatuese për secilën nismë ose projekt, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mandatin ligjor dhe institucional të palëve.

**Neni 4**  
**PARIMET E BASHKËPUNIMIT**

Bashkëpunimi do të udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, konfidencialitetit, paanshmërisë, transparencës, integritetit profesional, mos-diskriminimit dhe respektit të standardeve të barazisë gjinore. Palët do të bashkëpunojnë në mirëbesim, duke përcaktuar menaxherë koordinues dhe, sipas nevojës, grupe pune për monitorim të aktiviteteve. Qasja e përgjithshme parashikon përcaktimin e përgjegjësiave dhe kornizave të zbatimit në dokumente të ndara.

**Neni 5**  
**DUKSHMËRIA DHE PËRDORIMI I EMRIT/EMBLEMËS**

Palët mund të njoftojnë publikisht për bashkëpunimin vetëm pas pëlqimit paraprak me shkrim të palës tjetër dhe në përputhje me politikat e komunikimit dhe udhëzimet e dukshmërisë. Përdorimi i emrit, logove dhe simboleve zyrtare lejohet vetëm me autorizim paraprak me shkrim

**Neni 6**  
**SHKËMBIMI I INFORMACIONEVE, KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE**

Palët do të shkëmbejnë informacione të nevojshme për zbatim, duke respektuar konfidencialitetin dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe institucionale, në përputhje me parimet dhe rregullat e përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi.

**Neni 7**  
**ETIKA, PËRPUTHSHMËRIA DHE STANDARDET E SIGURISË**

Palët angazhohen të zbatojnë standardet etike dhe të respektojnë legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë parandalimin e konfliktit të interesit, anti-korrupsionin dhe mos-diskriminimin. Aktivitetet në ambientet e institucioneve përkatëse, do të respektojnë rregullat e sigurisë, protokollet e hyrjes dhe verifikimet e nevojshme.

**Neni 8**  
**ASPEKTET FINANCIARE**

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi nuk krijon obligime financiare për asnjërën palë.

**Neni 9**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Palët bien dakord të zgjidhin çdo mosmarrëveshje përmes konsultimeve miqësore. Kjo marrëveshje nuk krijon marrëdhënie juridike të detyrueshme, por përcakton vullnetin për bashkëpunim institucional dhe profesional.

**Neni 10**  
**KOHËZGJATJA, PËRFUNDIMI DHE NDRYSHIMET**

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe zgjat për një afat të pacaktuar, duke u bazuar në vullnetin e lirë të palëve nënshkruese. Çdo ndryshim ose plotësim i kësaj marrëveshje bëhet vetëm me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim ndërmjet palëve.

2. Marrëveshja është nënshkruar në dy (2) kopje identike origjinale, për secilën palë nënshkruese.

Nënshkruar me datë: 29.04.2026 në: Prishtinë

**PËR: FONDACIONI JAHJAGA**

Znj. Egzona Bexheti  
Drejtoreshë Ekzekutive

*E. Bexheti*



**PËR: ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT**

Znj. Vlora Spanca  
Auditore e Përgjithshme

*V. Spanca*

